REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

Drejtoria e Arsimit
Nr. 07-Zyrtarisht
09.07.2024

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 17, shkronja h) të Ligiit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHTI:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT DHE INSTITUCIONIN E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP). PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

1. Giimnazi "Vëllezërit Frashëri" në Decan

DREJTIMI: SHKENCA NATYRORE
NXËNËS 5x25 =125 nx.

DREJTIMI: SHKENCA SHOQËRORE - GJUHËSORE
NXËNËS 5x25 =125 nx.

Giithsei: 250 nxënës

## II. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) ' 'Tafil Kasumai"në Decan

TEKNOLOGJI E INFORMACIONIT TE TIK
PROFILET ARSIMORE:
TEKNIK 1 ELEKTRONIKES 1x20 = 20 nx.

TEKNIK 1 SISTEMEVE TË TIK 2x20 =40 nx.

Dr. Arsimit 21339
07 08.07.24

MEKATRONIKË

PROFILI ARSIMOR:
MEKATRONIKË 1x18 =18 nx.

MAKINERI
PROFILET ARSIMORE:

AUTOMEKANIK/DUAL 1x18 =18 nx.

INSTALUES 1 NGROHJES E KLIMATIZIMIT DHE UJËSJELLËSIT 1x18 = 18 nx.

EKONOMI
PROFILET ARSIMORE:
NÉNPUNÉS 1 KONTABILITETIT 1x18 = 18 nx.

MARKETINGUT 1x18 = 18 nx.

TREGTI ME SHUMICË DHE PAKICË 1x18 = 18 nx.

HOTELJERI
PROFILET ARSIMORE:
ASISTENT RESTORANTI 1x18 = 18 nx.

KUZHINJER 1x18 = 18 nx.

AGROKULTURË, PYLLTARI, PESHKATARI DHE VETERINARI,

PROFILET ARSIMORE:

HORTIKOLTURË 1x18 = 18 nx.

AGROBIZNES 1x18 = 18 nx.

SHËNDETËSI
SHËNDETI DHE MIRËQENIA•.
BASHKËPUNËTORE PROFESIONAL 1 INFERMIERISË 1x32 = 32 nx.

Gjithsej: 272 nxënës

## Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të Gjimnazit dhe të (IAAP), për vitin shkollor 2024/2025, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët kanë mbaruar arsimimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

## Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën teknike, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën ne të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

## Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve:

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnaz dhe IAAP — për vitin shkollor 2024/2025, bëhet me datën 10, 11 dhe 12 korrik 2024 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallën në shkollat përkatëse me datën: 13.07.2024

## Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

| | |
|---|---|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikéve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 % pikë.

AFATI I ANKESAVE

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit kanë të drejtë ankese, brenda dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë behën në DKA-në komunale brenda dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

Vërejtje: Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbjen e të drejtës për ankesë në shkallën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit (MASHTI). DKA dhe MASHTI nuk i shqyrtojnë asnjë ankesë nëse ajo nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.

Drejtori i DKA-së:

**Besnik Hulaj**